BKSH

HISTORI E TEQES
SË
MELÇANIT

I_bëj tjetrit atë që t'a ënda t'a bëjnë ty
Mos i bëj tjetrit atë që s'ta ënde t'a bëjnë ty

Botim i Irë

Prej

DÈRVISH FEIM HAMDI BITINCKA
Ndenjës në Teqe të Melçanit

KORÇË
Shyp. dhe Libr. Dhori Kotti, — Korçë
1935

Bitincka, F. H.

K. Histori e Teges së Melçanit. Bot. i I-rë. Korçë, Shtyp. dhe Libr. Dhori Koti, 1925.

48 f.

891·983-141+
+297(496·5)(0:8)

HISTORI E TEQES SË MELÇANIT

(I bëj tjetrit atë që t'a ënda t'a bëjnë ty)
(Mos i bëj tjetrit atë që s'ta ënda t'a bëjnë ty)

Botim i Irë

Prej

DERVISH FEIM HAMDI BITINCKA
Ndenjës në Teqe të Melçanit

KORÇË
Shtyp. dhe Librar', Dhori Koti, — Korçë
1936

BKSH

Më par t' lusim Zotit Perëndi
edhe Muhametit me Alinë
bashkë Hysejn e Hasan
edhe Ehlilbejtit ç'janë

Për riza të Perëndis këndoni
Fatiha me Sallavat

BKSH

Parëthënie

Zotërinj këndues!

Më parë se të filloj për të rrëfyer ç'ngjau në Teqe të Melçanit në Matemin e vitit 1924; dua t'u kërkonj ndjes prej jush, sepse munt që kam bërë ndo një gabim, në orthografinë e shkrimit.

Pra, nuk është për çudi se, s'kam mbaruar as ndo një shkollë, prandaj nuku di gramatikë.

Edhe për këtë libre nuk kam as një far' interesi tjetër, për veç që më shtrëngoj tepër mallëngjimi, prandaj dua t'u jap pak kuptim, për ç'ngjau me të vërtet.

Se punët që rodhë i pash vet isha edhe unë brenda në Teqet.

Si thot arësyeja një fial' t'urtë.

{ I bëj tjetrit atë që t'a ënda t'a bëjnë ty }
{E mos i bëj tjetrit atë që s'ta ënda t'a bëjnë ty}

Prandaj

(Kërkonj ndies e i u porosit)
(T'a merni pjes e mërgoni ligësit)

Dervish F. H. Bitincka

Bismil-lahir-rrahman ir-rrahim.

Sefte të them bismil-lah
All-llahu' bëftë qerem,
Jardëmxhi hazreti shah
Një histori do të them.

Do të nis të them o Zot!
Për ashku! imam Hysejnit,
Që hoqi mundime plot
Pe dyshmanve t' ehlibejtit.

Për ashkut të Muhametit
Ofëne do të them All-llah,
Se ay i di hikmetet
Mua m' a bëftë kollaj.

Për Alin' e për Hysejnë
Për Hasan e për Zyhranë,
Për Muhamet Mustafanë
Gjith' ehlibejtë ç' janë.

Unë jam garip njeri
Ngjarjet i pash vërtet,
O! Zot, ti, fort mir e di
Të lutem të bësh himet.

Dymbëdhjet Imam ç' janë
Ju lutem edhe ju them,
Janë zotrinjtë t' anë
Për neve bëfshin qerem.

Unë Fehim Hamdi i mjerë
Më s' di se si t' i lëvdoj,
Jardemxhi t' i kem për herë
Se ata nuku kan shoq.

Lartësi e ehlibejtit
Është pa anë e pa funt,
I lëvdojti Zoti vet
Ndë kuran e ndë Zeburt.

Ndë Inxhil e ndë Tevrat
All llahu ata i nderoj,
E i dërgoj më dynjat
Për neve të mjerit punoj.

Iziet hoqnë vërtet
Për të bër imtihan,
I shkroj Zoti n' ajet
Neve na i lan miras.

"In-nema jyridyll-llahy lijydhibe anqymyr-rixhsy ehlibejti ve jytah-hiruqym tathira."

Me këtë ajet i lëvdoj
Zoti i math e i vërtet,
Edhe neve na i dërgoj
Që t' i njohim të vërtet.

Fakir Fehim Hamdi i mjerë
Si lëvdim do të them ca fjalë,
Ngaj ahu që kam në zemërë
Pa nuku ja kam takanë.

Qani Xhanl'ar të qajmë
Për Hysejn e për Hassanë,
Për Fatimenë e për Alinë
Q' u përpoqnë për njerinë.

Ata për ne u përpoqnë
Mun dë zijar të math u doqnë,
Të gjith shehit i bënë
Jezidia paçin nëmë.

Ehlibejti gjithë ç' qenë
Qerbela e patnë dhenë
Me gjak me plukur u lyen
Qysh duruan fëmi e mjerë.

Amani! qani të qajmë
Edhe zih të math të mbajmë,
Të qajmë ne me gjith zembërë
Lot pe gjaku të na bienë.

Do të qaj sa të verbonem
Shpirtin mos e kursejmë,
Për ato ngjarje që tregonen
Për këto halle që rëfejmë.

T' i thëresim Imam Hysejnit
Ngaj sanxhaku të mos n' a nxjerë,
Për ashkut Imam Zejnelit
Të na ket kur do herë.

Që ndë vaktit Qerbelasë
Që i u dhanë iziet,
Kështu nuku kishte ngjarë
Jezitët paçin lanet.

Po jo sa ndë Qerbela
Atje s' shkruhet me kalem,
Se Hysejni ish Imam
Për neve bëfshin qerem.

Sa një zemre do të them
Ngjau në Teqqet Melçan,
All-llahu bëftë qerem
Më Jezitët n'artë hak.

Ka thën Zoti n' ajet
Për ata që janë të liq,
Edhe që s' bëjnë mehramet
"Lanet Kamiz-Zalimin."

Ata kur marin fursat
Myminit i mundojnë,
I shau Zoti në Kurant
Edhe ne do t' i a u këndojmë.

Unë dot i u jap lanet
Atyre që janë të liq,
Se na dhan iziet
Ndë hënët të Matemit.

Neve kujtonimë Hysejnë
Edhe mbanimë Matem,
Hallet e tij të rëfejmë
Ay të bëjë qerem.

Ndë hënët të Muharemit
Hysejnë e bën sheshit,
E I vanë Xhehen-nemit
Lanet i u qoftë ay shpirt,

Hysejni vati ndë Xhenet
Me të gjith shyhedanjtë,
Edhe gjith ehlibejt
Ishin me buzë të tha!ë.

All-llahu i bëri imtihanë
Edhe i a u pa kuv-vetnë,
Ishin njerës me byrhan
Bën kurban shpirtin e trupnë.

"Men jeqa alel Hysejni ev teba që vazhibi lehyl Xhen-neti."

Tha Hazreti Muhamet
Me këtë Hadithi Sherif,
Kush qan për Imam Hysein
E ka Xhen-netnë nasip.

Kush e do Imam Hysejnë
Edhe me lot kush e qan,
E ka ndihmë Fatimenë
Ndë Xhen-net e ka meqan.

Muhammeti me Alinë
Ishin një shpirt e një trup,
Hysejn e kishin dritë
Ehlibejtin nevxhud.

Gjith njerës ehlibejt
Ata sa do të lëvdosh,
Janë njerës të vërtet
Edhe nuku kanë shoq.

"Thoni lanetull-llahi alejh kavmiz-zalimin
Thoni rahmetull-llahi alejh kavmil-myminin".

E vërteta përparoftë
Ligësia lanet qoftë

Fillim i Historis së Teqes Melçanit.

Prap do them bismil-lah
Aman ja Zot' i vërtet,
Qerem ja hazreti shah
Për neve të bësh himet.

Do të nis për ndë Melçan
Se u ndodha ndë Teqqet,
Për ca njerës pa iman
Deshnë të fitojnë mesnet.

Kjo shkruhet Histori
Që të mbetet në dynja,
Mos punoj liksht njeri
Se fiton lanetull-llah.

Zylfoja u bë sebep
Për të vajtur në Melçan,
Ay desh të bëhej Mbret
S' deshën Myhiban e Ashikan.

Ay nuku kish kuv-vet
Ishte pa din, pa iman
Për të ndenjur ndë Teqqet
Se ishte bërë pishman.

Ay kishte shumë kohë
Për të bërë ligësi,

Gjer sa i erdhi në dorë
E mbaroj muratn' e tij.

Muhib-ban e Ashikanë
Se ishte ehli iman,
E deshën Qazim babanë
Për të bënin feda xhan.

Musa i Qazim Babanë
Ay ishte si Ferishtetë,
Ata nuk e duanë
Po i japin iziet.

Kjo dynja kështu ka shkuar
Jezitit t' i japish lanet,
E drejta ka mbretëruar
E do vej në xhen-net.

Zylfoja gjeti fursat
Gjeti kohën të ligë,
Ca njerës qenë kumandar
Ndodhëshin në qeverit.

Ndë Qeverit të Shqipris
Ata qen huqumdar,
Më vendit të mbretëris
Ata ishin kumandar.

I pari ishte Fan Noli
Atë e kishin si plak,
Edhe Kasëm Qafëzezi
Gurakuqi hiqej mi math.

U mblodhë e i dhan karar
Për të vajtur në Teqqet,

Te bëhej Zylfoja kumandar
Po ç' na dhanë izijet.

Njerëzit e Qeverisë
Ç' u lipsej për në Teqqet,
Na nakatosnë ndë besë
Kjo s' është punë për mbret.

Ata ishin njerës xhail
E punuan kondra,
Po Zylfoja sa çudi
Edhe hiç nuku u mejtua.

S' mejtoj imam Hysejnë
Që ish Hëna, Muharem,
Myhibit bëjnë matemnë
All-llahu të na bëj qerem.

Ajdar Qencka u bë mbret
E kishte hipur tamau,
U ngrit e vajti në Teqqet
Grat, matemit i rrahu.

Zylfoja i dha ca mall
Që vajti me ushtëri,
Një mulli e një luath
Pandaj punoj ligësit.

Gjoja i thoshin baba
Ay ishte bërë mbret
Ay deshte shumë mall
Mos do t' a merte ndë dhet!

Edhe kjo një hikmet
Si Ymersadi në atë vakt

U ngrit vajti në qofet
Veten e bëri ispat.

I dhanë dy vilajete
Rihjen e Taheristanë,
Që të kishte me vete
E haroj Muhamet Mustafanë.

Edhe vajti qelbela
E vravi Imam Hysejnë,
Edhe u bë lanetull-lla
Mori më qaf vehtenë.

Njeriu të ket kanaet
Të thot shyqyr Ali-llah,
Se kështu bëhet lanet
E fiton lanetull-llah.

Kjo do mbetet Histori
Kurdoherë të këndohet,
Të mos bëj liksht njeri
Që të vejë në Xhenet.

Kush ësht mymin sadik
Të mbahet gjith një në besë,
Të njihet që është mik
Se bëhet balt e qofesë.

(Lanetull-llahi alejh ala kamviz-Zalimin)
(Rahme'ull-llah alejh ala kavmiz-sabrin)

E vërteta përparoftë
Ligësia lanet qoftë

Histori e nëntë ditvet të matemit.

Bismil-lahir-rrahmanir-rrahim
All-llahu bëftë qerem
Se ç' më pa ky syri im
Do t' a shkruaj me kalem.

O! kalem t' u thaftë gjuha
Tinë ç' do të shkruash tani?
Të ligut murati i u mbarua
Tashi e bëri bel-li!

Zerë shkruaj e mos përto
Të marin vesh njerëzia,
Këta t' i njohin kushdo
T' u këndohet ligësia!

Kush e do Imam Hysejnë
Sa të jetë gjithësia,
Për të, të mbajë matemnë
T' a ket mik Perëndia.

Tarihu ishte një mijë
E treqint e dyzet,
Pas këtaj kush do, t' a dijë
Se na zu një kjamet.

Na ngjau si ndë qerbela
Në hënët të Muharemit,
Ca njerës u bënë bela
Shumë na dhanë iztet.

Dero Qencka e Zylfoja
Thoshin jemi Bektashij,

Ata po fitojnë bela
Në kishin pasur erzeli.

Ata po të kishin hak
Nuku bënin hakaret,
Ndë Matem nuk derthnin gjak
Deshin që të bëhen mbret.

Ditën që lindi Hëna
Vajti me Gjindarmarit,
Dero Qencka po mer bela
Kërkon të bëhet i lik.

Ajo dit e Muharemit
Muhiban e Ashikan,
Qajnë hallet e Hysejnit
Ay të na bëj derman.

Një djal ngaj Panariti
Ojoja e quanin Irfan,
Ay m' u duk si Veliti
E pyeta më tha mervan.

Më tha me gojët të tij
Deshte të thoshte Irfan
Po kjo s' është për çudi
Mundet që ishte mervan.

Dero Qencka e Irfani
Hynë brenda në Teqqet,
Të nxirnin Qazim Babanë
Bënë shumë hakaret.

Muhiban e Ashikanë
Ishin mbledhur në Teqqet,

Qanin për Qazim babanë
Se, e donin me gajet.
Se ishte njeri Mymin
Punon për rizat të All-llahut,
Të liqtë nuku e njinin
Hasmët e Hazret i Shahut.

O! bobo! si s' u mejtuan
Hajdër Qencka e Irfani,
E muar Qazim babanë
Ndë Korçë u ngritn' e vanë!
Muhib-ban e Ashikanë
Për ujë k'shin hararet,
Vetëm s' e lanë babanë
Hoqnë shumë iziet.

Babanë shum e shtrënguan
Thoshin tinë mos i duaj,
Këta ty le të të duan
Se kjo punë s' të del kollaj!
Babaj tha do vdes si burrë
Kush të më dojë do t' a dua,
Unë nuku trembem kurrë
Shpirti nuk më dhëmp mua,

Jam njeri mymin sadik
Të vërtetën nuk e le,
Me mua kush të jet mik
Le ta bëj terxhybe.
Dëgjoni tashi t' ju them
Këto dit mos na mundoni,

Se neve mbajmë matem
Do një nëmë mos fitoni.

Është Hëna e Muharemit
Se neve jemi Bektashi,
Qajmë hallet e Hysejnit
Të na jetë jardëmxhi.

Jemi me buzë të tharë
Menjtohi shumë vërtet,
Ini njerës kumandarë
Apo kërkoni mesnet.

Muhiban e Ashikan
Kur vinë këto dhjetë dit,
Qajnë vetëm Qerbelanë
Lanetull-llah Kavmi Jezit.

Se Hysejn e Fatimesë
Ndë këto dhjet dit,
E vranë kavmi pabesë
Lanetull-llah kavmi Jezit.

Të giithë i lanë pa ujë
Me shtatë dhjet e dy shpirt,
Ata s' u menjtuan kurrë
Lanetull-llah kavmi Jezit.

S' u menjtuan Jezidite
Gjer sa i bën sheshit,
E Xhuma ish ajo dit
Ndë vaktit të Namazit.

O! prefekt, urdhëro e folë
Hap gojën e më nep xhevap,

Prefekti tha, s' e kam në dorë
Edhe ruhsat, n iku t' ë jap.
Zotrote quhesh si ndë burg
Jashtë ngaj Korça mos dalç,
Mua më vjen shumë türp
Pe Tiranës kam telograf.
Tirana po e shtrëngonte
Zylfo Vërleni ish atje,
Telegrafnë po e dërgonte
Mbaroçni me axhele.
Tashi, i u gjetmë fursat
Ata kanë hararet,
Se tashi na erdhi rast
Ata janë ndë sëklet.
Dero Qenckë ti të veç
Ata njerës t' i shtrëngosh
Se ata kanë matem
Edhe punë do mbarosh.
Dëro Qencka u gëzua
Desh të vinte në Tęqqet,
Ndë për Korç' u harbua
Se do bënte Hakaret.
O bobo! si s' u mejtuanë
Ishte hëna Muharemit,
Imam Hysejnë s' e kujtuanë
Ishte dita Hararetit.
Bäbanë, ndë Korç' e mbajtnë
S' e lanë të vej në Teqqet
Po qysh nuku u mejtuanë

I dhanë shum iziet.
Ay e kish për gëzim
Si do që kish hararet,
Edhe thosh Allah qerim
Të falem ja Muhammet.
Gjith një po shtrëngonin
Edhe i epnin iziet,
Le t' a bënin si të donin
Vetëm e kish selamet.
Për ujë nxehej shumë
Ishte nxehtë me gajet,
Aman njëriut s' i thosh kur
Thoshte ja Hysejn medet.
Shyqyr që mu bë kësmet
Na munduan Xhailija
Se jemi me hararet
Lanet qoftë Ligësia.
Për Muhiban e për ashikanë
Për 'ta, më vien shumë keq,
Xhailija na munduanë
Se janë me Hararet.
Po, t' a ken për gëzim
Të thëresim Imam Hysejn,
Të thonë All-llah qerim
Se ay, neve, n' a gjen.
Myhiban e Ashikanë
Me foshnja e me gra,
Ndë Teqqet u ngritnë e vanë
Lot t' i derthnin, me gjakra.

Të gjith mbanin Matem
Ishin me buzë të tharë,
Allahu bëftë qerem
Martë hak më ata hyqmëdarë
Sa vinin po na shtrëngonin
E n' a jepnin iziet
Ca të parë po qëronin
I mernin me hakaret.
Rexhep Biranji ishte Sadik
Ish një plak i thinjurë,
E kallzoj një mynafik
E muar dyke lidhurë.
Ibrahim Maliq Tresova
Edhe Ismaila Kolaneci,
I kallzoj një që na u bë bela,
Ah! i dogji hararetil
Hysen Mytevelinë nga Korça
Metushnë e Burgarecit,
Maliqnë nga Porodina
Nurin e Damjanecit.
E Zenelë nga Melçani
E Sherifin e Libonikut,
Mustafanë nga Kolaneci
Edhe Asimn e Dërsnikut.
Edhe Dulen ngaj Pulaha
Edhe Koçin e Plovishtit,
Edhe Tosun nga Belertaja
Edhe Xhezar e Senishtit.
Një mynafik një jezit

Kallzoj shumë të tjerë,
M' u mërzit i shkreti shpirt
S' i tregova dot me emërë.
Ishin njëzet e ca shpirt
I muar i shpunë ndë hapsana,
Lanet i u qoftë ay shpirt
Të gjorët shum i mundoanë.
Njerës të liq pa merhamet
Këta të mjerit i burgosnë,
Ahl që kishim hararet
Edhe, hallet më s' ju sosnë.
Ndë burgut me izjet
Thërisnin ja imam Hyeejn,
S' pinin dot as një kafe
All-llahu bëftë qerem.
I mbuloj kara bojaja
Bën shum hakaret,
T' u japin lanet dynjaja
Edhe hazret Muhamet.
Me të dalë të Korrikut
Ishte nxeht me gajet,
Lanet i ap mynafikut
Atij që, u bë sebep.
Sido që ish nxeht shumë
Ndejnë si trima si burra,
Vetëm digjëshin për ujë
Jeziti e bëri ixhra.
Jezitvet dot i u ap lanet
Se c' një pa kv svri im,

O Zot të bësh merhamet
T' ja u març shpirtin me mundim.
Me bura edhe me gra
Shum ishin në Teqqet,
Lot e derthnin, me gjakra
Se na dhan iziet.
Qanin për imam Hysejnë
Kur e hapnja hadikanë,
Hallet e tij të rëfejmë
E tregonja Qerbelanë.
Ju thosha vini vesh e dëgjoni
Ç' hoqnë zotrinjte t' anë?
Hallet t' ona mos kujtoni
Neve mësime na i lanë.
Ne t' a kemi për gëzim
Se, është Hëna e Muharemit,
Të thomi All-llah qerim
Qajmë hallet e Hysejnit.
Sa po hapnja Hadikanë
E zinim që t' a këndonim
Kur shikonim më ç' do anë
Suarinjt s' na lironin.
Dit për dit kalorës vinin
Një ikte e një vinte,
Sa po vinte na shtrëngonin
Më s' e bëj dot terxhybe.
Me letra që ngaj Prefekti
Emri ish që ngaj Tirana,
Vinin e këndonin karshi

Shumë na u bënë bela
Si do i u bënim rixha
Sa të shkojnë këto dit,
Të këndojmë hadika
Mos bëhi njerës të liq.
Ligësinë e bënë ispat
Edhe s' bënin merhamet,
Xhevap kthenin me vrap
Juve s' kini selamet.
Ishin tre katër qint gra
Ca dërguan te Prefekti,
Përfaqësonjëse shtat gra
Ah! i dogji hareret.
Prefektit van i thanë
Tyne të bëjmë rixha,
Dërgoni Qazim Babanë
Se do filoni bela.
Muhiban e Ashikan
Me foshnja e gra,
Qajmë për Qazim Babanë
Ju mos na bëhi bela.
Prefekti i u dha xhevap
"E kam emrin ngaj Tirana,
Unë lejë nukë i jap
Se më nxierin ngaj puna."
O Prefekt t' u thafte gjuha
Tinë s' paske xhesaret?
Se neve na previ vapa
Edhe kemi hararet!

Ne kështu e kemi besën
Ndë këto dhjet dit,
Ujë s' pim ne e presim
Na i previ kavmi jezit.

Imam Hysejn Alinë
Ndë këto dhjet dit,
S' i u dhan ujë të pinë
Gjer sa i bën shehit.

Ju njerës të Qeverisë
Neve ju bëjmë rixha,
Mos nakatosni ndë besë
Dhe mos na bëhi bela.

Prefekti i u tha vërtet
"I kanë dhën vendim,
Juve s' kini selamet
Juve më s' kini shpëtim."

O bobo! të mierat gra!
Punë nuku mbaruan dot,
Se nuku ju shkoj rixhaja
Syt i kishin me lot!

Prap erdhë ndë Teqqet
Haber kështu na i dhanë
Gjith kishin hararet
Një helmë të hidhur lëshuanë!

Digjoni moj motra t' ona
"Neve vamë te Prefekti
Rixhaja s' na u dëgjua
Ah! na dogji harareti."

Gjith ç' qen ndë Teqqet
Këtë haber kur dëgjuan,
Qenë shum me gajet
Lotet si breshër ju vanë.

Ahl kur vinte shkreta natë
Kishim shum hararet,
Qanin foshnja qanin gratë
Se na dhan iziet.

Mernja; hapnja hadikanë
Edhe i u epnja gajret,
Ç' hoqnë zotërinjtë t' anë
Edhe ne na u bë kësmet.

Është hëna e Muharemit
Ndë këto dhjet dit,
Hoqi Hysejni Muhametit
Latull-llah Kavmi Jezit.

Edhe ne na u bë kësmet
Po jo sa ç' hoqnë ata!
Neve, kaqe kemi kudret
Shyqyr elhamdy lil-lah!

Shyqyr të themi vërtet
Jemi me buzë të tharë,
Ata s' bën merhamet
Kërkojnë të bëhen barbarë.

Ata e bën ispat
Që na dhan iziet,
Lanet, muar më dyujat
E, më devr kiamet.

Ah! kur vinte e shkreta ditë!
Ishte nxeht me gajet,
Lanet i jap ligësisë
Kishim shum Hararet.

Se neve kishim matem,
Ata s' na linin rehat!
All-llahu bëftë qerem
Mi ligësit martë ak..

Që ditën që lindi Hëna
Gjer sa u bë tet dit,
Qanin foshnja qanin gra
Lanetull-llah kavmi jezit.

T'enjten më sahati shtat
Na u mblodhë një mexhelis,
Ndë Tebojat Kasabas
Ca njerës të Qeveris.

U mblodhë i dhanë karar;
Për të vajtur në Teqet,
S'u mejtuan ata hyqmëdar
Se ishte një hakaret!

Selfo Starja si një i lik
Atë e bën kumandar,
Të vinte me ushtërit;
Desh të bëhet tetar!

Selfo Starja u gëzua
Se do vinte në teqet,
Ndë për Korçë u harbua
Se do fitonte mesnet.

Prap e panë me mynasip!
Që t' enjten më s' kishte vakt,
Për të vajtur me ushtërit
E lanë për më sabaht!

Kështu i dhanë karar
Për të vajtur në Teqet,
Ishin të gjithë Zyrtar
Akoma deshin mesnet.

Selfo Starja ish bër mbret
Kurulldisej si kumandar,
Na dha shum iziet
Të njihej se ish Zyrtar.

T'enjten shum na shtrëngonin
Nuku na jepnin derman,
Gjith, kalorës na dërgonin
Pastaj do bëhen pishman.

Një kalorës qe fodull
Ay shum na shtrëngonte,
Nuku vinte me usull
Se mesnetnë do fitonte.

Ish nga Selenica e Pishës
Gjoja e quanin Nevrus,
Nga një katunt i Kolonjës
Ay ishte vet mamus!

Kur vinte me madhëri
Deshte t' a bënte ixhra,
Vinte me një rëndësi
Ay na bëhej bela.

T' enjten shum na shtrënguan
Kishin shum hararet,
Suvarinjt s' na liruan
Se to vinin të nesërmet.

Edhe kjo një hikmet
Gjan si ndë qerbela,
Kur shkruaj zemra më dridhet
Imam Hysejni, shehid ra.

Ndë vaktit të qerbelas
T'enjten i 'dhan karar,
U mblodhë mexhelis i ixhras
Se ata ishin kumandar.

E panë që më s' kish vakt
Të lëftonin atë dit,
Jezitët e bën ispat
Lanet paçin Harixhitët

E lanë për më sabah
Do të bënin Hakaret,
Se gdhihej e xhuma
Se, do fitonin lanet.

Nesërmet u gëdhi xhuma
Bën shum hakaret,
U ngritnë që më saba
Edhe fituan lanet.

{Thoni lanetull-llahi alejh, ala kavmil Jezidin}
{Thoni rahmetull-llahi alejh, ala kavmil Mumenin}

E vërteta përparoftë
Ligësia lanet qoftë

Dita e Xhumasë

Bismil-lahir-rrahmanir-rrahim
Zot i math e i vërtet,
Je një gafurur-rrahim
Për neve të bësh him-met.

Do të nis me bismil-llah
Do rëfenj një hakaret,
Aman ja hazreti all-llah
Se na dhan iziet.

Je një Zot i math pa anë
Që bën shumë merhamet,
Të març hak mi ata dushmanë
Jezitët paçin lanet.

Kur vjen dit e xhumasë
Që të falen Myslimanët,
I lutem Zotit të lartërë
Ajy të na bëj dermanët.

Gjith kush është jezit
Kur vjen dita e Xhumasë,
Do punoj ligësit
Barbarizma e dynjasë.

Që ndë vaktit t' Ademit
Edhe sot e kësaj dite,
Jezitët e Imam Hysejnit
Kështu punojnë hakerete.

Imamë Hazret Alinë
Ditën që ish e xhuma,
E vranë ata Lainë
Fituan lanetull-llah!

Edhe shah imam Hysejnë
Me shtatë dhjet e dy shpirt,
Ditën e Xhuma e vranë
Lanetull-llah kavmin jezit.

Ah syt e mij seç më panë
Ditën që ish e xhuma,
Ata shum na munduanë
Ah! sa na u bën bola.

Atë nat muarmë haber
Që gëdhihej e xhuma,
Do vinin shum asqer
Të na nxierin nga Teqeja!

Qanin foshnja qanin gra
Se kishin shum hararet,
Dot' na vinin më saba
Dot na ipnin iziet.

Mernja, hapnja hadikanë
Edhe i u epnja gajret,
Ç' hoqnë zotrinjtë t' anë
Ju mos kini kasavet.

Shyqyr që na u bë kësmet
Që ditën që lindi hëna,
Nëntë dit na dhan iziet

Është hëna e muharemit
Shyqyr na u bë kësmet,
Kujtojmë hallet e Hysejnit
E, na dhanë iziet.

Sabahu kur zu të hapet
Pamë shumë llahtari,
Vaij-llahi shumë më qahet
Si do t' a shkruaj këtë Histori?

Kush është safi Beklashi
Ndë hënët të muharemit
T' a këndoj këtë histori
T' i api kanet jezitit.

Ca flinin e ca u zgjuanë
Kur panë një hikmet,
Teqenë na i rethuanë
Ata që kërkonin mesnet.

Kur vamë i hapnë portat
I shohim si mërëri
Të gjith ishin zymtitak
Mbushur plot me ushtëri.

Selfo Starja më parë erdhi
Hajdër Qëncka vajti ndë fshat,
Pastaj Irfan Panariti
Madhërinë e bën ispat.

Unë i u nxora kafenë
Ata s' e bën kabuil,
Kafenë nuku e pinë
Se ishin shumë foduil!

Një djali ja dhash tepsinë
Shahinit ngaj Lumalasi
M' erdhi keq se s' ma pinë
Ah! Nxehta gjesh më plasi.

Shahini shpuri brenda
Më vendit e la tepsinë,
S' ja u bëri kësmet hazreti sha
Ata nuk patnë besimnë.

Ata mund që e pandehnë
Se mos ish kafeja me helmë
Se i ligu ka shum frikë
Siç ka folur Muhameti velë.

"Elhatnyu haifyn"

Ah kur zunë na shtrëngonin
E na ipnin iziet,
Me za të math shkrifonin
Deshin që të bëhen mbret.

Selfo Starja u gëzua
Iriani ish bër mbret,
I mbiodhi burra e gra
Gjoja i u apin nasihet.

"Na thoshin juve të ikni
E, mos rini ndë teqet,
Kemi emër ngaj Prefekti
Se dot bëjmë hakaret."

"Me foshnja, edhe me gra
Muhiban e Ashikan,
Dot i u nxierim përjashta
Se do lemë Hajdëranë."

Xhevapnë kështu ja u dhamë
Me burra edhe me gra,
Ne duam Qazim babanë
Ju mos na bëhi bela.

Ju njerës të Qeveris
Mos nakatosni në fe,
Ndë shtëpit të Perëndis
Se fituat lanet'ënë.

Kë të duan, do të mbajmë
Këtu brenda në teqet,
Këtë kanë bër koskat tona
Nuk esht pun' për mbret.

Irfani urdhëroj e tha
Të mblidhen të gjith burat,
E të dalin për jashta
Do t' ju them një nasihat.

Burat i mblodhi de hsi,
Gjoja u bën nasihat,
I gënjeu ay ibhsi
Selfo Starja erdhi ndë grat.

Irfani ngaj Panariti
Burat po i mban me fjal,
Ay shum na thëriti
Selfo Starja po ireh gratë.

Selfo Starja erdhi ndë grat
Edhe po i u ep ca fial,
Ju thoshte t' dini me vakt
Se do lesë Hajdar anë.

Një letër zu të këndojë
Ja ku kam emrin ngaj Tirana,
Juve dot ju rrëfejm me të fort
Se do të mbetet Hajdar Qëncka.

Grat i dhan xhevapne
"Neve s' ikim nga teqeja,
Ne duam Qazim babanë
Juve u rëntë rrufeja.

Juve nuku paski turp
Mos pakatosni në teqqet,
Juve e bët pa neja
Nuk është mirë për mbret.

Ju lutemi të na lini
Se neve kemi motem,
Mos e bëni si jezit
Që të mos t'uai rëm.

Të na lini e dy dit
Sa të mbarojm ashyrenë,
Pa pastaj bëni jezit
Edhe të mbaroni punë.

Se sot i dërë e xhuma
Hysejnë e bën shehit,
Ngjan si ndë Qerbela
Lanetull-llah kavmi jezit."

BKSH

Selfo Starja dha një emër
Xhandarmarisë syngjitak,
U lëshuan për një herë
Punuan sa s' kishin hak.

O bobo! si s' u mejtuan
Bën shum hakaret,
Ndë mes të gravet u lëshuan
Fituan nëm e lanet.

Si ujku kur hyn ndë bagëti
Edhe çan dhenj pa hesap,
Se nuku i ngopet syri
Ligësinë e bën ispat.

Ah! kur bën hakaret
Mua m' u prish shum gjaku,
Ju thash u bë lanet
Ju vraftë persë shpejti haku.

Juve me grat ç' kini
Unë gjoksin ja u hapa,
Këtu po të doni bini
Shpirti nuk më dhemp mua.

E vranë imam Hysejnë
Ndë këto dhjet dit,
Un s' e kursej vehtenë
Se juve, ini jezit.

Juve s' u mejtuat kurë
Se neve kemi matenmë,
Kështu s' kishte ngjar kur
Veç kur vran imam Hysejnë.

Neve kemi hararet
Jemi me buzë të tharë,
Juve s' bëki meramet
Që jini njerës komandarë.

Dot ju marin vesh Evropa
Që ini njerës të liq,
Paçi turp nga gjithë bota
Juve mos bëhi të liq.

Ata fiat nuk digjuanë
E po bëjnë hakaret,
Grat për krahu i muarë
Po ju japin iziet.

Një dial ish dy a tre viet
E quanin Demir Ali,
Shkeli një xhenabet
Sa xheç i dolli shpirti.

Dervish Abdullahu e pa
Me të shpejt vajti e mori,
Edhe e nxori për jashta
Sa, firom, mezi mori!

Foshnjat që ishin në gji
Qanin edhe lebetitnin,
Se e panë një llahtari
Se ushtëria po na thërisnin.

O bobo sa kjamet
Unë nuku e shkruaj dot,
Pashë shumë hakaret
Syt m' u mbushnë me lot.

Sa u përpoqnë të injerat gra
Kishin shumë hararet,
Ngjau si ndë qerbela
Jezitët paçin lanet.

Një zonjë nga Vashtëmia
Të shoqen e Maliqit,
E nxuar jashtë ngaj avllia
Do të jap lanet jezitit.

Ajo bëri ulërimë
Se e mbanin syngjirak,
Ne duam baba Qazimnë
Më juve All-llahu martë hak.

Xhvikon edhe Rabikanë
Edhe t' ëmën e Adilit
Jezitët shum i munduan
Lanet paçin pe rahimit.

E ëma e Qamilit ngaj Kloca
Ish me ethe e sëmurë,
E hoqnë xvar përjashta
Kish edhe etje për ujë.

Edhe t' ëmën e Salihut
Edhe Rakibenë e Korçës,
E të shoqen e Qerim Plakut
E të shoqen e Rexhep Pocestës.

Si këto ishin disa plaka
Që më s' kishin më fuqi,
Si shqerën që ngre zhgaba
Me shum forc e madhëri.

Ata nuku u mejtuan
Ishte hëna muharemit,
Nga disa pika gjak ju ranë
Se i goditnë me syngjit.

Moj Xheviko mos ki keq
Të ngjau si ndë qerbelat,
Si hazretit Zejnep
Jezitët q' e çkulnë leshrat.

Këto i zunë më parë
Edhe ju dhanë siklet,
Po kur e zunë me radhë
U bë m' i math kjamet.

Mu mërzit i shkreti shpirt
Si tregova dot me emërë,
Lanet paçin pe Aliut
Bën të matit hakaret.

Kë zinin për leshi
Kë zinin për krahu,
I rahu shum nuku qeshi
Lanet paçin ngai Ail-llahu.

Kush qante me ulërimë
Kush bënte gojret,
Kush thosh duam baba Qazimnë
Jezitët paçin lanet.

Kush e kish foshnjën më krahë
Kush e plasi mbë dhe,
Kush e kish mbë gjumë
Qanin shum me hidhërimë.

Qanin foshnja qanin gra
Se u bë një hakaret,
Ngjau si ndë qerbela
Kishim shum hararet.

Kush ju kthente xhevap
"Neve jemi gra të nderçme",
"Punuat ligësi pa hesap"
"Fituatë lanetleme".

"Ne duam baba Qazimnë"
"Nuku duam fjetër njeri",
"Të gjith bota e dinë"
"Ne s' duam ligësi."

Ata fial nuk dëgjonin
Po ju epnin iziet,
Të gjorët po i mundonin
Kishin shum hararet.

Une ju dhash xhevap
"Duroni moj motrat t' eme,
Ligësinë e bën ispat
E na dhan hidhërimnë.

Ju mos kini kasavet
Ngjau si ndë qerbela,
I munduan grat e ehlibejt
Jeziti gjë pa bër s' la".

"Burat i bën shehit
Grat i muar syngjitak,
I gjesdisnin ndë për Qofet
Pastaj Zoti mori hak.

Edhe ne ashtu na ngjavi
Sot i thonë e xhuma,
Jardemxhi Hazreti Piri
Jeziti gjë pa bër s' la.

Është hëna e muharemit
Neve kemi hararet,
Qajmë hallet e Hysejnit
Po na japin iziet."

O bobo! si s' u mejtuanë
E po bëjnë hakaret,
Grat një nga një i nxuarë
Jezitët paçin lanet.

E thyen derën me sëpatët
Bën shum hakaret,
Hynë brënda ndër konakët
Jezitët paçin lanet.

Grat thoshin dyke qarë
"Se iknë me llahtari,
Më mirë të na kishin vrarë
Si do venë më shtëpi?

Ne e deshëm Qazim babanë
Pandaj hoqmë iziet,
Jezitët punën e mbaruanë
Qerem ja shahë vlajet."

Burat e kishin de lisi
Po i mbanin syngjitak,
Shiko seç punon iblisi
Kishin frik mos derdhej gjak.

Të deshin për të lëftuar
Ata nuku vinin dot,
Ne jemi safi shqiptarë
Pandaj duruam me fort.

Kishim hallë të vatanit
Se jemi një shtet i ri.
Pandaj s' i erthmë karshi Mervan
Kur na hyri më shtëpi.

Kjo është shtëpia tonë
E kemi që faleni,
Dotë hikëm si të gjorë
Mos harrofsh moj Perëndi!!!

Muhiban e Ashikanë
Hikën me një llahtari,
Ndë teqet lanë Irfanë
Mbeti me gjith ushtëri.

Ne ishim pes dervishë
Qamë shumë me gajet,
Lotet na binin si breshër
Se vetëm ushtëria mbet.

Dervish Isuf i mjerë
Kur pa atë hikmet,
E zu dridhej si purtekë
Dervish Aliu i tha hëj garjet.

Mua e dredhura më vjen vet
Kështu si u bë teqeja?
Lanet paçin jezidit
Edhe ju rëntë rufeja.

Unë e zura e pushtova
Edhe i dhashë garjet,
Qerbelanë ja kujtova
Edhe mos ki kasavet.

Dero Qencka ish ndë fshat
Kurulldisej po si mbret,
Pastaj erth, me gjindarmat
Edhe hyri ndë teqet.

Kur hyri brenda de porta
Gjith ushtëria ç' qenë,
Ju ngritnë me temena
Ahere e nxiu Teqenë!!!

Kish edhe dy njerës pas
Ata hiqëshin si bejler,
S' u mejtuan ata vesvas
Paskëtaj muar lanetnë.

O bobo! ajy i math
Kur vajti, ndenji më posht,
U kurulldis mun si mal
S' u mejtua hallet e Hysejnit.

U nxi e u bë si sterë
Ngaj hakaretet që punoj,
S' e kujtoj imam Hysejnë
Kam frikë se e fitoj.

Ishte hëna e muharemit
Dita ishte e xhuma,
S' kujtoj hallet e Hysejnit
Po fitojn tebera.

Neve të pes dervishët
Edhe gjith shërbëtorë,
Me vrap i muarmë këmishët
Edhe ikmë si të gjorë.

Ata s' deshin të na linin
Dero Qencka bëri emër,
Ne Dervishvet mos na linin
Që të bënte Ashurenë.

Unë ju ktheva xhevap
Hajdeni ore vëllezër,
T' ikëm neve me vrap
Këta janë të pa besë.

Ky është i mahniturë
Me gjith këtë ushtëri,
Duhet haxhetisurë
Që punojti ligësi.

Punojti shumë hakaret
Ndë hënët të muharemit
Ne na dha shum sëklet
E fitoj pe Muhametit.

Ishim me buzë të tharë
Ata na dhan iziet,
Thoshin jemi komandarë
Gjer më devër kjamet.

Kur ikmë ne ngaj teqeja
O bobo me dyke qarë,
Jezitvet ju rëntë rufeja
Se ishim me buzë të tharë.

Neve vamë Lumelas
Ndenjmë atje sa u çlothmë,
U ngritmë nd' atë çast
Pa pastaj arthmë në Korçë.

Kur pamë Qazim Babanë
O bobo! një kjamet,
Lotët ngaj syt na ranë
Se na dhanë iziet.

Prap e kishim për gëzim
Që ishte hëna e Muharemit,
Babaj na tha "All-llah qerim
Jemi bendet e Hysejnit."

Jemi me buzë të tharë
Ata na dhan iziet
Ata janë komandarë
Ne do kemi sclamet.

Po tashi si do të bëjmë
Ku do gjejmë një shtëpi?
Që të nxierim Ashyrenë
All-llahu na qoftë jardemxhi."

Një plak na u ndoth atje
Atë fialë kur dëgjoj,
Psherëtiti me vetje
Qau sa mezi pushoj.

Ishte Mersin Belortaja
Babajt vajti i ra nder këmbë,
"Shtëpia ime është tëndia,
Po të vish e të bësh çorbë."

Mersini shtëpinë e hapi
Bëri shumë xhesaret,
Jardëmxhi Haxhi Bektashi
E nxiertë mbi selamet.

Muhiban e Ashikanë
Që ishin ehli mymin,
Haber ja u dhanë
Te Mersini të vinin.

Muhiban e Ashikanë
Të gjith çqenë,
Te Mersini u mblothnë e vanë
Edhe e bën Ashyrenë.

Edhe atje sa po u mblothnë
Nuku na lan rehat,
E thirë plaknë e gjorë
Po e bënin istindak.

Plaknë e thirë ndë qeverit
Edhe shum e shtrënguan,
"I than pse i hape shtëpit
Ardhi shum Muhiban."

Plaku ndenj si trim si burë
Pastaj i u ktheu xhevap,
"Unë nuku trembem kurë
Edhe shtëpinë do t' a hap.

Kështu e kemi hadet
Neve bëjm Ashyrenë,
I mblidhemi shum me gajet
Thëresëm për imam Hysejnë.

Juve po të mos mbesoni
Dërgoni nja dy polica,
Ç' do të bëjmë ju të shini
Pastaj t' ju dali frika."

Ata mbesim nuku kishin
Dërguan nja dy polica,
Ndenj që të na shinin
Kishin frik sa xheç u ra pika.

Gjer e nxuarin Ashyrenë
Ata na dhan iziet,
Fituan lanetlemenë
Gjer më devr kjamet.

Amani xhanllar qani
"Më parë për imam Hysejnë,
Pastaj qani për dergjahnë
Paçi ndihmë Fatimenë.

Qani për Hysejn Hasanë
Jezidia i munduanë,
Ata për neve u vranë
Qani Muhiban e Ashikan.

Qani të qajmë me lot
Për ngjarjet e Qerbelasë,
Se hoqnë mundime plot
Fëmijët e Ali Abasë.

Prap qani të qajmë
Teqenë, e Qazim Babanë,
Jezidia e munduanë
Me Muhiban, e Ashikanë.

Qani të qajmë teqenë
Kush ka pies njerëzie,
Muhiban e Ashikanë
Falëtoren Bektashie.

*Thoni lanetull-llahi alejh kavmiz-zalemin
*Thoni rahmetull-llahi alejh kavmiz-sabrin

E vërteta përparoftë
Ligësia lanet qoftë

Elhak-katy melhak-katy
Vema edraqe melhak katy

Këthen Zoti n' ajet
Për ata që bëjnë ligësi,
S' mbetet hak për Ahrer
Do t' a marë vetë Zoti.
Të kisha një barrë kartë
Këto janë dhjetë dit,
Ata shumë na munduanë
Nuk shkruaj dot me divit.
Një kazan me myreqep
Po unë nuku kam fuqi,
Kur shkruaj zemra më dridhet
Lotet më derdhen si shi.
Ca të paka i tregova
Që të mbetet Histori,
Jezitvet murati i u mbarua
Qerem ja hazret Ali.
I kam fjalët të vërteta
Se kjo u bë ndë shesht,

E muar vesh gjith evropa
Fituan nëm për jetë.

Aman ja Haxhi Bektash
Të lutëm edhe të them,
Mi jezitët të març hak
Vetëm ti të bësh qerem.

Për Ashkut imam Hysejnit
Aman ja Hazreti pir,
Edhe të ballëm sulltanit
Vetëm ti na ki ndë fiqirë.

I lutem imam Hysejnit
Ngaj sanxhaku mos na nxierë,
Për Ashkut imam Zejnelit
Të na ket kur do herë.

Kur vjen hëna e muharemit
Kush është mymin Sadik,
Të qaj hallet e Hysejnit
Ndë Xhenet të na ket mik.

Hallet e imam Hysejnit
Të kesh të gjitha me bejte,
Gjith qejtë t' i kesh kartë
Edhe detn' e Zi myreqep.

O bobo! këta jezit
Se menjtuanë imam Hysejnë,
Punuan shumë ligësitë
Fituan lanet lemenë.

Kush është has Bektashi
Ndë henet të Muharemit,

T' a këndoj këtë Histori
T' i apë lanet jezitit.

Edhe ata që dëgjojnë
T' u japin nga një lanet,
Këta të liq po kujtojmë
Hiç të mos ken kasavet.

Juve njerës që dëgjoni
Gjuhënë mos e përtoni,
Lanetnë gjith t' a këndoni
Mi ata që janë jezit kavmi.

Fakir Feim Hamdi i miere
Gjer këtu i dhashë fund,
Jardemxhi Hazreti Pire
Edhe Hazretnë vedud.

[Thoni lanetull-llahi alejh ala Kavmix-Zalimin]
[Thoni Rahmetull-llahi alejh ala Kavmil myminin]

Arabi Viti 1343 Muai Mehar-remyl haram Dita 21.

Rumi Viti 1340 Muai Qusht dita 7.

Ndenjës në Teqe të Melçanit
Dervish F. M. Bilincka

BKSH

ВКSH

BKSH